



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

PROJEKT

V E N D I M

Nr. _____, datë _____.____.2016

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PER RREGULLAT E HOLLËSISHME,
PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK BIMOR DHE ALGAVE TË DETIT DHE
KONTROLLIT TE TYRE”¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe nenit 13 pika 3, nenit 18, 24, 33 dhe 36 të ligjit Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për rregullat e hollësishme, për prodhimin biologjik bimor dhe algave të detit dhe kontrollit të tyre”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Trupat e Kontrollit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 889/2008, datë 05 shtator 2008, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit 834/2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike në lidhje me prodhimin biologjik, etiketimin dhe kontrollin”, të ndryshuar. Numri CELEX:02008R0889-20160507, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L Nr. 250, dt. 18.9.2008, faqe 1-17.

RREGULLORE

“PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK BIMOR DHE TË ALGAVE TË DETIT DHE KONTROLLIT TË TYRE”

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Kjo rregullore përcakton rregullat e hollësishme: për prodhimin biologjik bimor, algave të detit dhe kontrollit të tyre, për prodhimin bimor dhe algave të detit në kalim, përjashtuese të prodhimit për prodhimin bimor, për njoftimin e aktivitetit dhe formën e certifikatës së operatorit.

Neni 2

Perkufizime

Përvec perkufizimeve të përcaktuara në ligjin Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, për qëllim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) ‘jo-biologjike’: ka kuptimin që nuk vjen nga, ose nuk ka lidhje me prodhimin e prodhuar në përputhje me ligjin Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

b) ‘fermë’, përfshin të gjitha njësitë e prodhimit që funksionojnë nën një menaxhim të vetëm për qëllim të prodhimit të produkteve bujqësore;

(c) ‘njësi prodhimi’ janë të gjitha asetet që përdoren në një sektor prodhimi të tilla si: objektet prodhuese, toka bujqësore, kullotat, sipërfaqe të hapura, objektet ku mbahen kafshët, **pellgje peshkimi, fish ponds, sistemet e kontrollit/hermetizimit të algave të detit ose specieve nën akuakulturë, koncesionet e bregut apo shtratit të detit**, objektet për magazinimin e prodhimeve bujqësore, produkteve bimore, produkteve shtazore, produkteve të algave të detit, lëndët e para dhe çdo inputi tjetër që lidhen me një sektor të veçantë të prodhimit;

(d) ‘prodhimi hidroponik’ është metoda e rritjes së bimëve me rrënjët e tyre vetëm në një tretësirë ushqyese minerale ose në një mjedis të ngurtë, si perlite, zhavorr ose fibër guri të cilave u shtohet një tretësirë ushqyese;

e) “energji nga burime të rinovueshme”, janë burimet e rinovueshme të energjisë jo-fosile: era, dielli, gjeotermale, valë, të baticës, hidrocentralet, gaz nga landfillet, gazi dhe biogazet nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza;

(f) "dosja e kontrollit", përfshin të gjitha informacionet dhe dokumentacionin që transmetohet, për qëllim të sistemit të kontrollit, tek autoriteti kompetent ose trupa e kontrollit nga një operator që është subjekt i sistemit të kontrollit, siç përcaktohet në nenin 30 të ligjit Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”,

përfshirë të gjithë informacionin përkatës dhe dokumentet që kanë të bëjnë me atë operator apo aktivitetet e tij, të mbajtura nga autoriteti kompetent dhe trupat e kontrollit, me përjashtim të informacionit ose dokumenteve që skanë asnjë lidhje me funksionimin e sistemit të kontrollit.

g) “pleh biologjik”, produktet e jashtëqitjes nga blegtoaria, apo një përzierje e produkteve të jashtëqitjes nga blegtoaria të lëngshme dhe të ngurta, madje në formë të përpunuar.

KREU II

REGULLAT PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK BIMOR

SESIONI I

Prodhimi bimor

Neni 3

Rregulla të përgjithshme

Në prodhimin biologjik bimor, përvec kërkesave të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, zbatohen edhe kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 4

Menaxhimi dhe plehërimi i tokës

1. Kur nevojat ushqyese të bimëve nuk plotësohen nga zbatimi i masave të përcaktuara në Nenin 12(1)(a), (b) dhe (c) të Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre, në prodhimin biologjik bimor mund të përdoren vetëm plehurat dhe përmirësuesit e tokës të përcaktuara sipas nenit 16, pika 2 të Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe vetëm në masën që është e nevojshme. Operatorët duhet të mbajnë regjistrat për përdorimin e këtyre produkteve.

2. Vlera e përgjithshme e plehut organik, të përdorur në fermë, nuk duhet të kalojë sasinë 170 kg azot në vit / hektarë . Ky kufizim zbatohet vetëm në përdorimin e plehut organik të fermës, plehut të thatë të fermës dhe plehut të dehidruar të shpendëve, jashtëqitjet e kafshëve të kompostuara përfshirë plehun e shpendëve, plehun e fermës të kompostuar dhe jashtëqitjet e lëngshme të kafshëve.

3. Fermat e prodhimit biologjik mund të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi me fermat ose stabilimentet e tjera që janë në përputhje me rregullat e prodhimit biologjik, me qëllim shpërndarjen e plehut të tepërt nga prodhimi biologjik. Kufiri maksimal, i përcaktuar në pikën 2, llogaritet në bazë të të gjitha njësive të prodhimit biologjik të përfshira në këtë bashkëpunim.

4. Preparate të përshtatshme nga mikroorganizma mund të përdoren për të përmirësuar kushtet e përgjithshme të tokës ose për sigurimin e lëndëve ushqyese në tokë ose në bimët bujqësore.

5. Për aktivizimin e kompostove të plehërave, përdoren preparate të përshtatshme me bazë bimore ose preparatet nga mikroorganizmat.

Neni 5

Ndalimi i prodhimit hidroponik

Në sistemin e prodhimit biologjik, ndalohet prodhimi hidroponik.

Neni 6

Menaxhimi i dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të egra

1. Në prodhimin biologjik, kur bimët nuk mbrohen në mënyrë të përshtatshme nga dëmtuesit dhe sëmundjet nga masat e përcaktuara në nenin 12 (1)(a), (b), (c) dhe (g) të Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre, mund të përdoren vetëm produktet e përcaktuara në nenin 16, pika 2 të Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre. Operatorët mbajnë prova të dokumentuara mbi nevojën për përdorim të produktit.

2. Për produktet që përdoren në kurthe ose metoda çorientuese, përveç ferromoneve çorientuese, kurthet dhe/ose metodat çorientuese duhet të parandalojnë çlirimin e substancave në mjedis dhe kontaktin ndërmjet substancave të përdorura dhe bimëve të kultivuara. Kurthet mblidhen pas përdorimit dhe hidhen në mënyrë të sigurt.

Neni 7

Rregulla të veçanta për prodhimin e kërpudhave

Për prodhimin e kërpudhave, mund të përdoren substratet, vetëm nëse ato përbëhen nga përbërësit e mëposhtëm:

(a) plehu i fermës dhe jashtëqitjet e kafshëve:

(i) ose nga fermentat që prodhojnë sipas metodës së prodhimit biologjik;

(ii) ose që përfshihet në listën sipas nenit 16, pika 2 e ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, vetëm kur nuk gjendet produkti i përmendur në pikën (i); dhe kur ato nuk kalojnë 25 % të peshës totale të përbërësve të substratit, me përjashtim të materialit mbulues dhe të ujit të shtuar para kompostimit të plehrave;

(b) produktet me prejardhje bujqësore, të ndryshme nga ato të përmendura në pikën (a), nga fermentat që prodhojnë në përputhje me metodën e prodhimit biologjik;

(c) torfë që nuk është trajtuar kimikisht;

(d) dru që nuk trajtohet me produkte kimike pas prerjes;

(e) produktet minerale, të përcaktuara sipas nenit 16, pika 2 të Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, ujë dhe toka.

SEKSIONI II

Prodhimi i algave të detit

Neni 8

Fusha e veprimit

Ky seksion përcakton rregullat e hollësishme për mbledhjen dhe kultivimin e algave të detit. Këto rregulla zbatohen për prodhimin e të gjitha algave shumë-qelizore detare ose fitoplanktoneve dhe mikro-algave për përdorim të mëtejshëm si ushqim për kafshët e akuakulturës.

Neni 9

Përshtatshmëria e mjedisit ujor dhe plani i menaxhimit të qëndrueshëm

1. Aktiviteti prodhues duhet të vendoset në vende që nuk janë subjekt i ndotjes nga produkte ose substanca që nuk lejohen në prodhimin biologjik, apo ndotësve që ndikojnë në natyrën biologjike të produkteve.
2. Njesitë e prodhimit biologjike dhe jo-biologjike, duhet të jenë qartësisht të ndara. Një ndarje e tillë bazohet në situatën në vend, sistemet e ndara të shpërndarjes së ujit, distancat, natyrën e rrjedhjes, vendndodhjen e njësive të prodhimit biologjik. Autoriteti kompetent mund të përcaktojë vende ose zona të cilat konsiderohen të papërshtatshme për akuakulturën biologjike ose vjeljen e algave të detit dhe gjithashtu mund të përcaktojë distancat minimale ndarëse midis njësive të prodhimit biologjik dhe jo-biologjike. Kur distancat minimale ndarëse përcaktohen nga autoriteti kompetent, ai duhet të informojë operatorët dhe trupat e kontrollit.
3. Një vlerësim mjedisor në proporcion me njësinë e prodhimit kërkohet për të gjitha aktivitetet e reja që zbatohen në prodhimin biologjik dhe prodhimin e më shumë se 20 ton produkte të akuakulturës në vit, për të përcaktuar kushtet e njësive të prodhimit dhe ndikimet mjedisore të menjëhershme të funksionimit të saj. Operatori duhet të paraqesë vlerësimin mjedisor tek trupa e kontrollit. Përmbajtja e vlerësimit mjedisor, bazohet në kërkesat e legjislacionit në fuqi “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
Nëse njësia ka qenë objekt i një vlerësimi ekuivalent, atëherë lejohet të përdoret edhe për këtë qëllim.
4. Operatori duhet të sigurojë një plan të menaxhimit të qëndrueshëm në proporcion me njësinë e prodhimit për akuakulturën dhe vjeljen e algave të detit. Planin duhet të përditësohet çdo vit dhe të detajohen ndikimet mjedisore të aktivitetit, monitorimi mjedisor që do të ndërmerret dhe masat e ndërmara për të minimizuar ndikimet negative në mjediset ujore dhe tokësore, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, shkarkimin e lëndëve ushqyese në mjedis për cikël prodhimi ose për vit. Planin përfshin regjistrimet e mbikëqyrjes dhe riparimit të pajisjeve teknike.
5. Operatorët e biznesit të akuakulturës dhe algave të detit përdorin sipas preferencave burimet e rinovueshme të energjisë dhe materiale të ri-ciklueshme dhe hartojnë si pjesë të planit të menaxhimit të qëndrueshëm, një program të reduktimit të mbetjeve, që duhet të zbatohet që në fillim të aktiviteteve. Kur është e mundur, përdorimi i nxehtësisë së mbetur reduktohet nga përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme.
6. Për vjeljen e algave të detit, duhet të ndërmerret një vlerësim i biomasës që në fillim.

Neni 10

Vjelja e qëndrueshme e algave të egra të detit

1. Në njësinë ose objektet e prodhimit mbahet dokumentacioni financiar, i cili mundëson operatorin për të identifikuar dhe trupën e kontrollit për të verifikuar, se vjelësit kanë furnizuar vetëm alga deti të egra të prodhuara në përputhje me ligjin nr.106/2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollit të tyre".
2. Vjeljet kryhen në mënyrë të tillë që sasi të vjela të mos shkaktojë ndikim të ndjeshëm në gjendjen e mjedisit ujor. Për të siguruar që algat e detit mund të rigjenerohen, merren masa të tilla si: teknika e vjeljes, madhësitë minimale, moshat, ciklet e riprodhimit ose madhësia e algave të detit të mbetura.
3. Nëse algat e detit vilen nga një zonë vjelje në përdorim të përbashkët, dokumentacioni duhet të tregojë që e gjithë sasia e vjelur përputhet me këtë rregullore.
4. Në zbatim të nenin 30 (2) (b) dhe (c) të kësaj rregulloreje, këto të dhëna duhet të provojnë një menaxhim të qëndrueshëm dhe pa ndikim afatgjatë në zonat e vjeljes.

Neni 11

Kultivimi i algave të detit

1. Kulturat e algave në det përdorin vetëm ushqyesit që ndodhen natyrisht në mjedis, apo nga prodhimi i specieve biologjike të akuakultures, mundësisht të vendosura afër, si pjesë e një sistemi shumëkulture.
2. Në paisjet në tokë, kur përdoren burimet e jashtme ushqyese nivelet ushqyese në ujin rrjedhës duhet të jenë njëlloj, ose më pak të verifikueshme, se sa uji i ardhur. Vetëm ushqyesit me origjinë minerale ose bimore dhe që përfshihen në listën sipas nenin 16 (2) të ligjit nr.106 / 2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" mund të përdoren.
- 3.
3. Kur është e mundur, litarët dhe pajisjet e tjera të përdorura për rritjen e algave të detit ri përdoren ose të riciklohen.

Neni 12

Masat për pastrimin e makinerive dhe paisjeve të prodhimit

- Pastrimi i paisjeve dhe makinerive kryhet nëpërmjet masave fizike dhe mekanike. Kur kjo nuk është e mundur, mund të përdoren vetëm substancat e përfshira në listën sipas nenit 16, pika 2 të Ligjit nr. 106/2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre".
2. Organizmat e vogla, largohen vetëm me metoda fizike ose me dore dhe kur është e përshtatshme kthehen në det në një largësi nga ferma.

SEKSIONI III

RREGULLAT PËRJASHTUESE TË PRODHIMIT PËR PRODHIMIN BIMOR

Neni 13

Prodhimi paralel

1. Kur zbatohen kushtet e përcaktuara në nenin 23, pika 2 , gërma (a, të ligjit nr.106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjik dhe kontrollin e tyre”, një prodhues mund të menaxhojë në të njëjtën hapësirë, njësitë e prodhimit biologjik dhe jo-biologjik:

(a) në rastin e prodhimit të kulturave shumëvjeçare, të cilat kërkojnë një periudhë kultivimi të paktën tre vjecare, kur varietetet nuk mund të dallohen lehtë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

(i) Të gjitha njësitë e prodhimit përfshihen në një plan konvertimi në të cilin fillimi i kalimit në prodhim biologjik i parcelës së fundit, është brenda një periudhe maksimumi 5 vjecare;

(ii) merren masat e duhura për të siguruar ndarjen e përhershme të produkteve të prodhuara nga cdo njësi prodhimi;

(iii) trupa e kontrollit njoftohet për vjeljen e çdo produkti, të paktën 48 orë më parë;

(iv) kur përfundon vjelja, prodhuesi informon trupen e kontrollit mbi sasinë e vjela në njësitë e prodhimit dhe masat e zbatuara për ndarjen e produkteve;

(v) plani i kalimit dhe masat e kontrollit të përcaktuara në kreun V, Seksionet III dhe IV, miratohen nga trupa e kontrollit dhe raportohen tek autoriteti kompetent dhe ky miratim konfirmohet çdo vit pas fillimit të planit të kalimit;

(b) kur sipërfaqet bujqësore përdoren për kërkime bujqësore ose arsim profesional të miratuar nga autoritetet kompetente dhe kur provohet që plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën (a)(ii)(iii)(iv) dhe pjesën përkatëse të pikës (v);

(c) në rastin e prodhimit të farërave, materialit shumëzues bimor dhe zhvendosjes së tyre dhe kur provohet që plotësohen kushtet e përcaktuara në pikat (a)(ii)(iii)(iv) dhe pjesën përkatëse të pikës (v);

(d) në rastin e kullotave që përdoren vetëm për kullotje.

Neni 14

Përdorimi i farërave ose materialit shumëzues bimor që nuk janë përfituar me metodën e prodhimit biologjik

1. Kur zbatohen kërkesat e përcaktuara në nenin 23 pika 2 germa a të ligjit nr.106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjik dhe kontrollin e tyre”,

(a) mund të përdoren, farërat dhe materiali shumëzues bimor nga një njësi prodhimi në kalim,

(b) kur pika (a) nuk është e zbatueshme, trupa e kontrollit mund të lejojë përdorimin e farërave ose materialit shumëzues bimor jo-biologjike, nëse nuk gjenden nga prodhimi biologjik. Megjithatë, për përdorimin e farërave dhe farës së patates jo-biologjike, zbatohen kërkesat në vijim nga pika (2) deri (6).

2. Farërat dhe fara e patates jo-biologjike mund të përdoren me kusht që farërat ose fara e patates të mos trajtohen me PMB, të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 16, pika 2, të ligjit nr.106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjik dhe kontrollin e tyre”, përveç rasteve kur trajtimi kimik është **autorizuar/miratuar** për qëllime fitosanitare

nga autoriteti kompetent, për të gjitha varietetet e një lloji të dhënë në zonat ku do të përdoren farërat ose fara e patates.

3. Trupa e Kontrollit mund të lejojë përdorimin e farërave ose farës së patates jo biologjike, vetëm në rastet e mëposhtme:

(a) kur nuk gjendet asnjë varietet i llojeve që përdoruesi dëshiron të prodhojë,

(b) kur asnjë furnizues, që nënkupton një operator i cili i shet farëra ose farë patate operatorëve të tjerë, nuk është në gjendje të shpërndajë farëra ose farë patate biologjike përpara mbjelljes, në rastet kur përdoruesi ka porositur farërat ose farën e patates në kohë të arsyeshme;

(c) kur varieteti të cilin përdoruesi dëshiron ta përftojë nuk gjendet dhe përdoruesi ka mundësi të demonstrojë se asnjë nga alternativat e të njëjtit lloj nuk janë të përshtatshme, prandaj lejimi për tu përdorur është i domosdoshëm për prodhimin e tij;

(d) kur justifikohet përdorimi në kërkime, testime në fushë në shkallë eksperimentale ose për qëllime të ruajtjes së varieteteve të miratuara nga autoriteti kompetent.

4. Trupa e kontrollit duhet të lëshojë lejen para mbjelljes së produkteve.

5. Leja duhet të lëshohet vetëm për përdoruesit individualë, për një sezon për çdo periudhë, dhe trupa e kontrollit përgjegjëse për lejimin regjistron sasinë e farërave apo farës së patates të lejuara.

6. Në përjashtim të pikës 5, autoriteti kompetent mund t'i lëshojë të gjithë përdoruesve një leje të përgjithshme:

(a) për një specie të dhënë kur dhe për sa kohë plotësohet kushti sipas pikës 3(a);

(b) për një varietet të dhënë, kur dhe për sa kohë plotësohet kushti i përcaktuar në pikën 3(c).

KREU III

RREGULLAT E KALIMIT

Neni 15

Bimët dhe produktet bimore

1. Bimët dhe produktet bimore konsiderohen biologjike, kur në parcela zbatohen rregullat e prodhimit sipas neneve 9,10,11 dhe 12 të ligjit nr. 106/2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre" dhe rregullat e përcaktuara në seksionin 1 të kësaj rregulloreje dhe kur është e zbatueshme rregullat përjashtuese të prodhimit të përcaktuara në seksionin III gjatë periudhës së kalimit :

- të paktën dy vjet para mbjelljes së kulturave njevjeçare, ose,

- në rastin e kullotës ose foragjereve shumëvjeçare, të paktën dy vjet para përdorimit si ushqim për kafshë në bujqësinë biologjike, ose

- në rastin e kulturave shumëvjeçare përveç foragjereve, të paktën tre vjet para vjeljes së parë të produkteve biologjike.

2. Trupa e kontrollit mund të vendosë për të njohur në mënyrë prapavepruese si pjesë të periudhës së kalimit, çdo periudhë të mëparshme në të cilën:

(a) parcelat kanë qënë subjekt i masave të përcaktuara në një program zyrtar, me kusht që këto masa të sigurojnë që në parcela nuk janë përdorur produkte që nuk përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 16, pika 2, të ligjit nr.106/2016 “Per prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”,.

(b) ose parcelat kanë qënë tokë djerrë ose bujqësore djerrë, të cilat nuk janë trajtuar me produkte të palejuara për përdorim në prodhimin biologjik.

Periodha sipas pikës (b) mund të merret parasysh në mënyrë prapavepruese, vetëm nëse operatori i paraqiten prova dhe dëshmi të mjaftueshme trupës së kontrollit që vertetojnë se kushtet plotësohen për një periudhë të paktën tre vjecare.

3. Trupa e kontrollit, mund të vendosë të zgjasë periudhën e kalimit përtej periudhës së përcaktuar në pikën 1, në rastet kur toka është ndotur me produkte të palejuara për prodhimin biologjik.

4. Në rastin e parcelave të cilat janë kaluar ose janë në proces kalimi në prodhim biologjik dhe që trajtohen me një produkt të palejuar në prodhimin biologjik, autoriteti kompetent mund të shkurtojë periudhën e kalimit të përcaktuar në pikën 1 në rastet e mëposhtme:

(a) kur parcelat janë trajtuar me një produkt të palejuar për prodhimin biologjik si pjesë e masave të detyrueshme për kontrollin e sëmundjeve ose të dëmtuesve, të detyruara nga autoriteti kompetent;

(b) kur parcelat janë trajtuar me një produkt të palejuar për prodhimin biologjik si pjesë e testeve shkencore të miratuara nga autoriteti kompetent.

Në rastet e përcaktuara në pikat (a) dhe (b), kohëzgjatja e periudhës së kalimit caktohet duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

(a) procesi i degradimit të produktit të përdorur garanton një nivel të papërfillshëm të mbetjeve në tokë në fund të periudhës së kalimit, , dhe në rastin e kulturave shumëvjeçare, në bimë;

(b) prodhimi i vjelë pas trajtimit nuk mund të shitet duke iu referuar metodës së prodhimit biologjik.

5. Trupat e kontrollit duhet të informojnë autoritetin kompetent për të gjitha vendimet për zgjatjen ose reduktimin e periudhës së kalimit.

Neni 16

Algat e detit

1. Periudha e kalimit për një vjelje të algave të detit është gjashtë muaj.

2. Periudha e kalimit për një njësi kultivimi të algave të detit është më e gjatë se gjashtë muaj ose sa një cikël i plotë prodhimi.

KREU IV

RREGULLAT E KONTROLLIT

SEKSIONI IV

Rregullat e përgjithshme

Neni 17

Masat e kontrollit

1. Kur operatori aplikon për herë të parë në sistemin e kontrollit, ai duhet të hartojë/përpilojë dhe përditësojë:

- (a) një përshkrim të plotë të njësisë së prodhimit dhe/ose stabilimentit dhe/ose të aktivitetit;
- (b) të gjitha masat praktike që duhet të ndërmerren në nivel njësie dhe /ose stabilimenti dhe/ose aktiviteti, për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e prodhimit biologjik;
- (c) masat parandaluese që ndërmerren për të reduktuar rrezikun e ndotjes nga produktet ose substancat e palejuara dhe masat për pastrimin që ndërmerren në magazina dhe gjatë gjithë zinxhirit të prodhimit. Kur është e përshtatshme, përshkrimi dhe masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të jenë pjesë e sistemit të cilësisë të ngritur nga operatori.

Neni 18

Deklarimet nga operatori

1. Masat e përcaktuara në pikën 1, deklarohen dhe nënshkruhen nga operatori dhe ky deklaram përfshin edhe kërkesat si mëposhtë :

- (a) të kryejë aktivitetin në përputhje me rregullat e prodhimit biologjik;
 - (b), në rastin e shkeljeve ose parregullsive, të pranojë zbatimin e masave sipas rregullave të prodhimit biologjik;
 - (c) në rastin kur produkti nuk rezulton biologjik, të informojë me shkrim blerësit e produktit për të siguruar që treguesit që i referohen metodës së prodhimit biologjik janë hequr nga produkti,
 - d) në rastet kur operatori dhe / ose nënkontraktorët e tij janë kontrolluar nga trupa kontrolli të ndryshme në përputhje me kërkesat e ligjit nr.106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”,.. të pranojë shkëmbimin e informacionit midis trupave të kontrollit.
 - e) në rastet kur operatori dhe / ose nënkontraktorët e tij ndryshojnë trupën e kontrollit, të pranojë kalimin e dosjes së kontrollit tek trupa tjetër e kontrollit;
 - f) të pranojë, të informojë pa vonesë autoritetin kompetent, në rastet kur operatori hiqet nga sistemi i kontrollit,
 - (g) në rastet kur operatori hiqet nga sistemi i kontrollit, të pranojë që dosja e kontrollit të ruhet për një periudhë të paktën prej pesë vitesh;
 - (h) të informojë pa vonesë trupën e kontrollit për çdo parregullsi apo shkelje që ndikojnë në statusin biologjik të produkteve të tyre ose të produkteve biologjike të furnizuara nga operatorët e tjerë ose nënkontraktorët.
2. Deklarimet sipas nennit 18 pika 1 verifikohen nga trupa e kontrollit që lëshon një raport inspektimi i cili identifikon mangësitë e mundshme dhe jokonformitetet me rregullat e prodhimit biologjik. Operatori e nënshkruan raportin dhe ndërmerr masat korrigjuese të nevojshme.

Neni 19

Njoftimi i aktivitetit

1.Sipas nennit 34, pika 1, të Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, operatori i komunikon autoritetit kompetent informacionet e mëposhtme:

- (a) Emrin dhe adresën e operatorit;
- (b) Vendndodhjen e stabilimentit dhe kur është e nevojshme, parcelat (të dhënat e regjistrimit të tokës) në të cilat kryhet aktiviteti;
- (c) Natyrën e aktiviteteve dhe produkteve;
- (d) Deklaratën e operatorit për të kryer aktivitetin në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.
- (e) Në rastin e një ferme bujqësore, datën kur prodhuesi ka ndërprerë përdorimin e produkteve të palejuara për prodhimin biologjik në parcelat e saj.
- (f) Emrin e trupës së kontrollit me të cilën operatori ka kontraktuar.

Neni 20

Ndryshimi i masave të kontrollit

Operatori njofton në kohë trupën e kontrollit, për ndryshimet në përshkrimin dhe/ose masat e përcaktuara në seksionin IV dhe nenin 26 të kësaj rregullorje.

Neni 21

Kryerja e inspektimeve

1. Trupa e kontrollit kryen, të paktën një herë në vit, një inspektim fizik të të gjithë operatorëve,.
2. Trupa e kontrollit merr dhe analizon mostra për zbulimin e produkteve të palejuara për tu përdorur në prodhimin biologjik, për kontrollin e teknikave të prodhimit që nuk janë në përputhje me rregullat e prodhimit biologjik ose për zbulimin e kontaminimit të mundshëm nga produktet e palejuara për prodhimin biologjik.
Numri i mostrave të marra dhe analizuara cdo vit nga trupa e kontrollit, duhet të jetë të paktën 5% e numrit të operatorëve nën kontrollin e tyre. Përzgjedhja e operatorëve për të marrë mostra për analizim, kryhet mbi bazën e një vlerësimi të përgjithshëm të riskut të mospërputhjes me rregullat e prodhimit biologjik.
Ky vlerësim i përgjithshëm duhet të marrë parasysh të gjitha stadet e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.
Trupa e kontrollit merr dhe analizon mostra në cdo rast kur dyshohet që përdoren produkte apo teknika të palejuara për prodhimin biologjik.
Në raste të tilla nuk zbatohet asnjë kufizim në numër për marrjen e mostrave.
Gjithashtu, mostrat mund të merren dhe analizohen nga trupa e kontrollit, në cdo rast **tjetër** për kontrollin e teknikave jokonforme me rregullat e prodhimit biologjik ose për zbulimin e kontaminimit të mundshëm nga produkte të palejuara për prodhimin biologjik.
3. Pas çdo inspektimi përpilohet një *raport inspektimi*, i cili nënshkruhet nga operatori i njësisë ose përfaqësuesi i tij.
4. Trupa e kontrollit kryen inspektime të rastësishme, kryesisht të palajmëruara, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të riskut të mospërputhjes me rregullat e prodhimit biologjik, duke marrë parasysh të paktën rezultatet e inspektimeve të mëparshme, sasinë e produkteve në fjalë dhe rrezikun për shkëmbimin e produkteve.
Procedura për vlerësimin e riskut përcaktohet në mënyrë të tillë që:
(a) rezultati i analizës së riskut shërben për përcaktimin e intensitetit të inspektimeve të paparalajmëruara ose lajmëruara vjetore.

- (b) të kryhen inspektime të rastësishme shtesë, të paktën në 10% të operatorëve të kontraktuar në përputhje me nivelin e rrezikut;
- (c) të paktën 10% e të gjitha inspektimeve të jenë pa paralajmërim;

Neni 22

Mbajtja e llogarive financiare nga operatorët

1. Regjistrat financiarë dhe të prodhimit gjendje, mbahen në njësitë ose stabilimentet e prodhimit, të cilat mundësojnë operatorin të identifikojë dhe trupën e kontrollit të verifikojë:
 - (a) furnizuesin dhe kur janë të ndryshëm, shitësin ose eksportuesin e produkteve;
 - (b) natyrën dhe sasinë, e produkteve biologjike të shpërndara në njësi prodhimi, dhe kur është e përshtatshme e të gjitha materialeve të blera dhe përdorura, si dhe kur është e përshtatshme, përbërja e ushqimeve të kombinuara për kafshë;
 - (c) natyrën dhe sasinë e produkteve biologjike që mbahen në magazinat e operatorit/stabilimenteve;
 - (d) natyrën, sasinë dhe marrësit e ngarkesave dhe kur janë të ndryshëm, blerësit, të tjerë nga konsumatori i fundit, të çdo produkti që ka dalë nga njësia ose nga objektet e ngarkesës së parë apo magazinat e ruajtjes;
 - (e) në rastin e operatorëve të cilët nuk magazinonjë ose nuk trajtojnë fizikisht këto produkte biologjike, natyrën dhe sasinë e produkteve biologjike të blera dhe të shitura, dhe furnizuesit, dhe kur janë të ndryshëm, shitësit ose eksportuesit dhe blerësit dhe sipas rastit marrësit e ngarkesës.
2. Regjistrat e llogarive përmbajnë gjithashtu rezultatet e verifikimit në hyrje të produkteve biologjike dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga trupa e kontrollit me qëllim kryerjen e një kontrolli të saktë.
Të dhënat në regjistra shoqërohen me dokumentacionin e duhur provues. Llogaritë në regjistra duhet të tregojnë balancën ndërmjet hyrjeve dhe daljeve.
3. Kur operatori menaxhon disa njësi prodhuese në të njëjtin vend, njësitë e prodhimit jobiologjike, së bashku me magazinat e inpueteve, gjithashtu i nënshtrohen plotësisht të kërkesave të përgjithshme të kontrollit.

Neni 23

Aksesi në objekte

1. Operatori duhet të:
 - (a) lejojë trupën e kontrollit, për qëllim kontrolli, të ketë akses në të gjithë njësinë dhe gjitha objektet, si dhe në regjistrat e llogarive dhe dokumentacionin përkatës;
 - (b) ofrojë për trupën e kontrollit çfarëdo informacioni të nevojshëm për qëllim kontrolli;
 - (c) paraqesë, kur kërkohet nga trupa e kontrollit, rezultatet e programeve të sigurimit të cilësisë, të lidhura me prodhimin biologjik.
2. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 1, importuesit dhe marrësit e parë, paraqesin për ngarkesat e importuara informacionin e mëposhtëm:
 - (a) emrin dhe adresën e marrësit të parë;
 - (b) çdo hollësi që trupa e kontrollit kërkon në mënyrë të arsyeshme,

(i) në rastin e produkteve të importuara, në përputhje me nenin 37 ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, certifikatën e operatorit;

Me kërkesë të trupës së kontrollit të importuesit, ky i fundit përcjell informacionin e përmendur në këtë pikë tek trupa e kontrollit të marrësit të parë.

Neni 24

Certifikata e operatorit

Në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, trupat e kontrollit lëshojnë certifikatën e cila përmban gjithë informacionet e përcaktuara në Aneksin I të kësaj rregullorje. Në rastin e certifikatës elektronike duhet të ruhet origjinaliteti i saj.

Neni 25

Deklarata e shitësit

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, deklarata e shitësit që produktet e furnizuara nuk janë prodhuar nga ose me OMGJ përmban të gjithë informacionin në formën e përcaktuar në Aneksin II të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI V

Kërkesat e hollësishme të kontrollit për bimët dhe produktet bimore të prodhuara ose të mbledhura nga ferma

Neni 26

Masat e kontrollit

Pervec kërkesave të përgjithshme të përcaktuara në Kreun IV, për bimët dhe produktet bimore të prodhuara ose të mbledhura nga ferma, zbatohen edhe kërkesat e përcaktuara në këtë seksion.

1. Përshkrimi i plotë i njësisë sipas nenit 17, pika 1 germa a,:

(a) hartohet edhe kur operatori ushtron aktivitetin e tij vetëm në mbledhjen e bimëve spontane;

(b) përmban magazinat dhe ambjentet e prodhimit dhe parcelat dhe/ose zonat e mbledhjes së bimëve spontane, dhe kur është e zbatueshme, ambjentet në të cilat realizohen proceset e përpunimit dhe/ose paketimit dhe

(c) specifikon datën e trajtimit të fundit me produkte të palejuara në prodhimin biologjik, në parcelat dhe/ose zonat e mbledhjes;

2. Në rastin e mbledhjes së bimëve spontane, masat e marra në nivel njësie dhe / ose stabilimenti dhe / ose aktiviteti për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e prodhimit biologjik, duhet të përfshijnë një deklaratë nga palët e treta zyrtare për të siguruar që

plotësohen kërkesat e nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, .

Neni 27

Komunikimet

Çdo vit, para datës së kërkuar nga trupa e kontrollit, operatori e njofton atë lidhur me planin e prodhimit të produkteve bujqësore, të ndarë sipas parcelave.

Neni 28

Të dhënat për prodhimin bimor

Të dhënat për prodhimin bimor mbahen në formën e një regjistri dhe janë të disponueshme për trupën e kontrollit në cdo kohë në ambjentet e fermës.

Përvec planit të prodhimit sipas nenit 28, këto regjistra përmbajnë të paktën informacionin si mëposhtë:

- (a) për përdorimin e pleherave: datën e përdorimit, llojin dhe sasinë e plehut dhe parcelën ku përdoret;
- (b) për përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB): arsyen dhe datën e trajtimit, llojin e PMB, metodën e trajtimit;
- (c) për furnizimet me inpute të fermës: datën, llojin dhe sasinë e produktit të blerë;
- (d) për vjeljet: datën, llojin dhe sasinë e prodhimit biologjik ose prodhimit në kalim.

Neni 29

Menaxhimi i disa njësi të prodhimit nga një operator

Kur operatori menaxhon disa njësi prodhimi në të njëjtin vend, njësitë që prodhojnë prodhime jo-biologjike, së bashku me objektet e magazinimit për inputet në fermë, janë subjekt i rregullave të përgjithshme dhe Të hollësishme të kontrollit, të përcaktuara në Seksionin IV dhe V të këtij kreu.

SESIONI VI

Kërkesat e hollësishme të kontrollit për algat e detit

Neni 30

Masat e kontrollit për algat e detit

Kur operatori aplikon për herë të parë në sistemin e kontrollit, përshkrimi i plotë i njesisë së prodhimit përfshin:

- (a) një përshkrim të plotë të instalimeve në tokë dhe në det;
- (b) kur është e aplikueshme, vlerësimin mjedisor siç përcaktohet në nenin 9 pika 3;
- (c) kur është e zbatueshme, planin e menaxhimit të qëndrueshëm siç përcaktohet në nenin (49, pika 4;
- (d) për algat e detit të egra hartohet një përshkrim i plotë dhe një hartë e zonave bregdetare ose detare të grumbullimit dhe zonave tokësore ku ndodhin aktivitetet pas grumbullimit.

Neni 31

Të dhënat për prodhimin e algave të detit

1. Të dhënat për prodhimin e algave të detit mbahen në formën e një regjistri dhe janë të disponueshme për trupën e kontrollit në cdo kohë në ambjentet e fermës.

Këto të dhëna përmbajnë të paktën informacionin në vijim:

- a) listën e specieve, datën dhe sasinë e vjelës;
- b) për plehrat e përdorura, datën e përdorimit, llojin dhe sasinë e tyre.

2. Për mbledhjen e algave të detit të egra, regjistri përmban edhe:

- (a) historikun e aktivitetit të vjeljes për çdo specie në shtretërit e përcaktuar;
- (b) vlerësimin e prodhimit të pritshëm që mund të vilet (vëllimin) për sezon;
- (c) burimet e ndotjes së mundshme për shtretërit e vjelës;
- (d) prodhimi i qëndrueshëm vjetor për çdo shtrat.

ANEKSI I
CERTIFIKATA E OPERATORIT

<p>Certifikata e operatorit sipas nenit 35 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.</p>	
<p>1. Numri i dokumentit:</p>	
<p>2. Emri dhe adresa e operatorit.</p> <p>Aktiviteti kryesor (prodhues, përpunues, importues, etj)</p>	<p>3. Emri, adresa dhe numri i trupës së kontrollit:</p>
<p>4. Grupet e produkteve/aktiviteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bimët dhe produktet bimore, - algat e detit dhe produktet e tyre - kafshët dhe produktet shtazore -speciet nën akuakulture dhe produktet e tyre -produktet e përpunuara 	<p>5. të përcaktuar si:</p> <p>Prodhim biologjik, produkte në kalim; dhe gjithashtu prodhimi jo-biologjik kur ndodh prodhimi/përpunimi paralel sipas Nenit 11 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”,</p>
<p>6. Periudha e vlefshmërisë:</p> <p>Produkte bimore nga ...deri...</p> <p>Produkte të algave të detit nga ...deri...</p> <p>Produkte shtazore nga ...deri...</p> <p>Produktë të akuakulturës nga ...deri...</p> <p>Produkte të akuakulturës nga ...deri</p>	<p>7. Data e kontrollit (eve):</p>
<p>8. Ky dokument është lëshuar në bazë të nenit 35 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, dhe nenit 24 të kësaj rregullorje. Operatori i deklaruar i ka nënshtruar aktivitetet e tij sistemit të kontrollit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, dhe këtë rregullore.</p> <p>Data, vendi:</p> <p>Nënshkrimi në emër të trupës së kontrollit që lëshon dokumentin:</p>	

ANEKSI II

DEKLARATA E SHITËSIT

Deklarata e shitësit sipas nenit 9, pika 3 të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.	
Emri, adresa e shitësit:	
Identifikimi (p.sh numri i lotit apo stokut)	Emri i produktit:
Përbërësit: (Specifikoni të gjithë përbërësit që ekzistojnë në produktin/përdoren të fundit në procesin e prodhimit)	
<p>Deklaroj se ky produkt nuk është prodhuar as ‘nga’ as ‘me’ OMGJ, ashtu si këta terma janë përdorur në Nenet 3 dhe 9 të ligjit nr. 106/2016 “për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”. Unë nuk kam ndonjë informacion që mund të sugjeronte se kjo deklaratë është e pasaktë.</p> <p>Kështu, deklaroj se produkti i lartpërmendur është në përputhje me Nenin 9 të të ligjit nr. 106/2016 “për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, lidhur me ndalimin e përdorimit të OMGJ.</p> <p>Unë marr përsipër të informoj klientët tanë dhe trupën e kontrollit të tyre menjëherë, nëse kjo deklaratë tërhiqet ose ndryshohet ose në rast se paraqitet ndonjë informacion që çënon saktësinë e saj.</p> <p>Autorizoj trupën e kontrollit, e cila mbikëqyr klientët tanë, të verifikojë saktësinë e kësaj deklarate dhe nëse është e nevojshme të marrë mostra për vërtetim analitik. Gjithashtu, pranoj se kjo detyrë mund të kryhet nga një institucion i pavarur që është caktuar me shkrim nga trupa e kontrollit.</p> <p>I nënshkruari merr përgjegjësinë për vertetësinë e kësaj deklarate.</p>	
Shteti, vendi, data, nënshkrimi i shitësit:	Vula e kompanisë së shitësit (nëse është e mundur):